REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I DREJTESISË

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbledhje e Jashtëzakonshme)

(Mbajtur, më 19.11.2018)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Mbi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Vlorë për shkak se kryetarja aktuale, bazuar në vendimin e datës 15.11.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsiderohet e pezulluar nga detyra e gjyqtarit.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:30 dhe mbaroi në orën 19:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** ***(kryetar)***
2. ***Xhezair Zaganjori*** ***(anëtar)***
3. ***Gjin Gjoni*** ***(anëtar)***
4. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
5. ***Eneida Civici*** ***(anëtare)***
6. ***Petrit Çomo*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Astrit Haxhialushi*** ***(anëtar)***

[shqiptarja.com]

9. ***Gerd Hoxha*** ***(anëtar)***

10. ***Neritan Cena*** ***(anëtar)***

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ***z. Vangjel Kosta.***

Shënim 2: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018 bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka vendosur për subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht anëtar i KLD-sw z. Artan Broci, shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit. Deri në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimit ky gjyqtar, pezullohet nga ushtrimi i detyrës, parashikuar kjo specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.

4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.

5. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.

8. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.

10. Ekspertë të Misionit EURALIUS.

11. Ekspertë të USAID-it.

[shqiptarja.com]

RENDI I DITËS:

1. Mbi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Vlorë për shkak se kryetarja aktuale, bazuar në vendimin e datës 15.11.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsiderohet e pezulluar nga detyra e gjyqtarit.

Ilir Meta: Mirëmbrëma atëherë!

Vendosa të thërras këtë mbledhje, duke u nisur nga situata me Gjykatën e Apelit në Vlorë. Kështu që kërkohet një vendimmarrje për këtë çështje, sa më e shpejtë dhe po kështu, kemi përfshirë edhe delegimet, sipas praktikës së zakonshme.

Ka ndonjë merak tjetër për këtë mbledhje?

Vazhdojmë atëherë?

Dakord!

Mirë atëherë! Mbi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Vlorë për shkak se kryetarja aktuale, bazuar në vendimin e datës 'kaq e aq' të KPK-së konsiderohet e pezulluar nga detyra e gjyqtarit.

Këto janë listat e...?

Kush ka ndonjë propozim për komandimin?

Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Nisur nga lista që na është vënë në dispozicion, nga informacioni që kemi, unë do propozoja gjyqtarin Hysen Saliko, nisur nga përvoja e tij, vjetërsia, fakti që ka qenë edhe kryetar gjykate për një kohë të gjatë dhe anëtar i KLD-së.

Etilda Gjonaj: Tashti, unë do doja që në këtë situatë në të cilën ndodhen gjykatat, dhe kryetari i Gjykatës së Apelit ka një rëndësi shumë të madhe, të mundet të mbështesim më të mirët që i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore dhe neni 47, paragrafi 6 i ligjit 96/2016, ka përcaktuar kush janë kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë. Dhe me çfarë më rezulton nga kriteret ku thuhet që "*...të ketë ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se 7 vjet, gjatë të cilës, të paktën 4 vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative, etj.; përvoja si zëvendëskryetar; përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të*

[shqiptarja.com]

paktën në tre vjet më parë; njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme, etj.; dhe të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit..."

Stafi im ka studiuar, na rezulton që janë 9 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate:

Një gjyqtare, Brikena Ukperaj, është kandidate për Këshill të Lartë Gjyqësor dhe në konceptin tim, duhet të përjashtohet.

Petrit Aliaj është me një vlerësim "Mirë" dhe një "Shumë mirë" dhe përsëri, duhet të përjashtohet.

Klodiana Gjyzari është emëruar në Gjykatën e Apelit për herë të parë në 2014-ën (19.12.), pra nuk i ka 4 vjet në të njëjtën shkallë, kështu që rrjedhimisht, duhet të përjashtohet për sa kohë që nuk përmbush kriteret ligjore.

Hysen Saliko është emëruar fillimisht në Gjykatë të Apelit në 2010-2011, pastaj ka kaluar inspektor në KLD dhe është rikthyer në apel në vitin 2016, pra nuk i ka 4 vjet...

(Ndërhyjnë nga anëtarët pa ndezur mikrofonat.)

Okej, ta përfundoj edhe pastaj...

Ilir Meta: Mbani shënim kush ka për sqarim...

Etilda Gjonaj: Prandaj thash, nga të dhënat që stafi im ka nxjerrë.

Pra nuk i ka 4 vjet në të njëjtën shkallë, ka vetëm 3 vite dhe rrjedhimisht, duhet të përjashtohet.

Gjyqtarët e tjerë që mbeten janë Margarita Buhali, Nazmi Troka, Skënder Damini, të cilët janë emëruar fillimisht në apel në vitin 2013, pra i kanë 4 vjet në të njëjtën shkallë dhe Iliba Bezati dhe Sokol Ngresi, të cilët janë emëruar në Gjykatë Apeli në vitin 2005 dhe vitin 2003.

Duke marrë në konsideratë të dhënat që unë kam, do të favorizoja fort një kandidaturë e cila ka shumë vite në atë Gjykatën e Apelit Vlorë, ku respektivisht i bie Iliba Bezati ose Sokol Ngresi, të cilët janë në vitin 2005 dhe në vitin 2003. Dhe gjithashtu, do të preferoja fort që të mbështes një kandidaturë femër për kryetare gjykate.

Brunilda Kadi: Mundem, zoti President?

Kam përshtypjen që të dhënat e ministres nuk janë të sakta në lidhje me kandidaturën që unë propozova sepse nga informacioni që kemi ne dhe besoj që të

[shqiptarja.com]

konfirmohet, ky gjyqtar është emëruar në atë gjykatë në 2010 dhe inspektor ka qenë më përpara kësaj kohe. Kështu që mund të verifikohet. Ai ka qenë anëtar KLD-je me cilësinë e gjyqtarit të apelit nga ajo gjykatë.

Pjerin Prendi: Relacioni është i shpërndarë dhe e kanë të gjithë anëtarët.

Zoti Saliko është që në vitin 2010 që është anëtar i Gjykatës së Apelit të Vlorës. Tetë (8) vite. Të dhënat janë të sakta në relacion.

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Edhe unë bashkohem me Brunën për arsye sepse nga 2010 deri në momentin aktual ai është gjyqtar i Gjykatës së Apelit. Qenia e tij anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është pa ndërprerje nga puna. Nuk është se është shkëputur për shkak të qenies së tij si anëtar i KLD-së. Siç jemi ne sot. Të gjithë kryejnë funksionin e gjyqtarit dhe vijnë edhe në funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu që periudha para vitit 2010, ka qenë me cilësinë e inspektorit të KLD-së. Domethënë është 8-9 vjet pa shkëputje nga puna në të njëjtën gjykatë.

Xhezair Zaganjori: Unë të them të drejtën, me emrat tani u njoha dhe vonë e mora vesh edhe për mbledhjen dhe ndoshta s'kisha...

Ilir Meta: Pse vonë? Kur jeni lajmëruar për mbledhjen?

Xhezair Zaganjori: Unë kam qenë gjithë ditën nëpër gjyqe. Sot e kam marrë njoftimin.

Ilir Meta: Dakord! Dakord!

Xhezair Zaganjori: Është bërë sot?!

Pjerin Prendi: Është mbledhje e jashtëzakonshme, prandaj.

Xhezair Zaganjori: Në rregull, jam në gjendje ta marrë dhe të jap mendimin edhe sot, jam në gjendje. Veçse desha të njihesha me listën e gjyqtarëve dhe me CV-të e tyre. Kjo është e para.

E dyta, zoti President. Ndoshta ka rëndësi, nuk e di si është proceduar me zoti Saliko, që po propozohet, ose me ndonjë emër tjetër, por a është marrë pëlqimi i atyre që plotësojnë...? Kemi të drejtë t'i emërojmë edhe nëse ato nuk pranojnë? Kemi të drejtë t'i komandojmë edhe nëse nuk japin pëlqimin?

Ilir Meta: Edhe mund të merret pëlqimi nëse i plotëson kushtet...

[shqiptarja.com]

Xhezair Zaganjori: Jo, e kam fjalën, meqë mblidhemi për këtë punë, e mira do të ishte që... Faleminderit, zoti President!

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Gjin Gjoni: Besoj që Bruna që e propozoi, do ia ketë marrë pëlqimin.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Po!

Ilir Meta: Ti ke folur me...

Brunilda Kadi: Besoj edhe ministrja kam përshtypjen, atë që propozoi, ndoshta mund t'i ketë marrë pëlqimin.

Etilda Gjonaj: Jo! Ministrja nuk propozoi një emër konkret. Propozova disa.

Ishin pesë në fakt që në konceptin tim plotësojnë kushtet.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Të lutem, ta përfundoj!

...dhe thashë, të mbështesim kandidaturën që ka më shumë eksperiencë në atë gjykatë, meqenëse është një komandim i përkohshëm derisa të ngrihet KLGJ-ja dhe le të emërojë më pas kryetarin. Dhe ashtu siç thashë dhe e kam thënë edhe herë të tjera, mendoj që ne duhet të mbështesim një kryetare që të jetë femër, për shkak të gjithë karakteristikave, devotshmërisë në punë, që gjyqtaret femra kanë. Nga pesë kandidaturat që unë lexova, duke evidentuar kush ka më shumë eksperiencë pune, kush ka më shumë eksperiencë në atë gjykatë, evidentova dy emra nga pesë në total. Nuk i kam marrë pëlqimin askujt sepse nuk njoh askënd personalisht nga kjo listë dhe s'e kam pasur për detyrë që ta bëjë që të marrë pëlqimin.

(Zonja Kadi flet ma ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Nuk është shkelje e ligjit edhe sikur ta pyesësh.

Etilda Gjonaj: Pavarësisht.

Gjin Gjoni: Atëherë, meqenëse ka vetëm një emër zoti President... Në qoftë se ka një emër të dytë...

Ilir Meta: Të flasim me radhë.

Gjin Gjoni: Më fal, zoti President!

[shqiptaria.com]

Meqenëse ka vetëm një emër zoti President, në qoftë se ka një emër të dytë, le të hidhet në tryezë dhe të votohet për të parin dhe për të dytin ose në rast të kundërt, në qoftë se flitet në tërësi, të votohet emri dhe të mbyllet në lidhje me këtë. Se ligji kështu e kërkon, kërkon emër nominal.

Etilda Gjonaj: Nga të dhënat që u referuan tashti nga Inspektorati ose nga Sekretari i Përgjithshëm, rezulton që janë të dhëna të tjera nga ato çfarë unë kam si ministre. Nuk e di nëse përgjegjësinë e këtyre të dhënave e mban Sekretari i Përgjithshëm, patjetër i bie që mos të ketë...

Ilir Meta: Zoti Sekretar i Përgjithshëm mban përgjegjësi ti për atë që the që...?

Pjerin Prendi: Unë mbaj përgjegjësi për ato të dhëna që u janë dërguar të gjithë anëtarëve dhe të dhënat që u janë dërguar të gjithë anëtarëve dhe bashkë me to edhe ministres, janë ato të dhëna që ka ministrja mbi tavolinë.

Ilir Meta: Kjo që kemi ne këtu.

Pjerin Prendi: Ajo që është aty. Që ka 10 vjet... Që në 2010-ën besoj. Pastaj sesi lexohen nga të tjerët, këtë nuk e kam detyrim.

(Zoti President flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Meta: Dakord! Ka nevojë për pak minuta kohë për riverifikime? Të mendohet për një kandidaturë tjetër nëse...

Etilda Gjonaj: Një ndër kriteret të 47/6 thuhet që të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

Ilir Meta: I Këshillit të Lartë të Drejtësisë?

Etilda Gjonaj: Po! I Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhe me të dhënat e fundit, na rezulton që 2011-2016 ka qenë anëtar KLD-je, kështu që është një kriter skualifikues.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Po ajo është për kryetarët, nuk është për komandimet.

Etilda Gjonaj: Po çfarë rëndësie ka? Po flasim për kriteret që parashikon 47/6 lidhur me kryetarin.

Gerd Hoxha: Meqenëse flasim për përgjegjësi këtu, do të doja nga të gjithë përgjegjësi dhe nëse kemi ardhur këtu për të bërë shou *(show)* apo mos t'i lexojmë gjërat siç duhet, mund të presim të dalim përjashta kur të vijnë kamerat dhe të flasim për gjëra

[shqiptarja.com]

që... Këtu jemi të përgjegjshëm për aq kohë sa do ta mbajmë këtë detyrë dhe ministrja bën mirë të jetë e përgjegjshme për ato që thotë sepse këto që shkruhen i kemi të gjithë përpara, i kemi të gjithë njësoj.

Sa i përket ligjit, ai ligj nuk ka veprim prapavepruese (ligji i ri), kështu që neni 46 *(është lapsus, bëhet fjalë për nenin 47/6)* nuk vlen për rastin e zotit Saliko. Unë do të kërkoja më shumë kurajë edhe nga ministrja këtu në qoftë se thotë të mbështesim një kandidate femër, të na thotë emrin e asaj kandidateje dhe mos ta lë... Siç bëjmë të gjithë. Nëse ka ardhur këtu pastaj për të mos qenë korrekte apo serioze në mbledhje, është punë e saj.

Petrit Çomo: Marrë shkas nga ajo 'për përvojën', femër këtu Margarita Buhali, në 2013-ën është caktuar në apel, jo në 2005-ën. Kurse Sokol Ngresi është më i vjetri si përgjegjësi. Ndërsa unë mendoj që të votojmë dy kandidatë. Të votojmë më shumë se një. Mos të votojmë vetëm për një.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Ilir Meta: Në qoftë se vlerësojmë për shembull që zoti Saliko nuk e plotëson një kriter, të shohim për kandidatura të tjera që plotësojnë kriteret. S'kemi ndonjë urgjencë.

Brunilda Kadi: Zoti President, ideja është që duhet të mbajmë një standard në të gjitha rastet sepse i gjithë ky diskutim kaq i thelluar nuk është mbajtur në rastet e tjera kur kemi komanduar kryetarë gjykatash. Kështu që, në qoftë se do shikojmë pastaj me lupë, mirë është ta shikojmë tek të gjithë dhe të mbahet një standard, siç kemi vepruar edhe në dy rastet e tjera që kemi komanduar, apo tre. Sa janë? Përveçse është komandim dhe ne nuk mund të rrimë... Edhe asaj që tha Gerdi, për pjesën e ligjit, por edhe është komandim. Nuk jemi duke emëruar kryetar.

Xhezair Zaganjori: Kemi ndjekur këtë praktikë edhe pa pëlqimin e vetë?

(Anëtarët përgjigjen 'po'.)

Ilir Meta: Po, ministrja!

Etilda Gjonaj: Unë do doja që t'ju thoja që, në çdo deklaratë publike dhe gjithashtu në mbledhje, jo vetëm që kam mbajtur përgjegjësinë e çfarëdolloj që kam deklaruar me mikrofon dhe pa mikrofon, por edhe nga ana tjetër mendoj që, është e vërtetë që është komandim, por për sa kohë që janë përcaktuar disa kritere minimale për

[shqiptaria.com]

kryetarin e gjykatës, duhet t'i qëndrojmë me analogji edhe në rastin kur ne i komandojmë një gjyqtar të kësaj gjykate në pozicionin e kryetarit të gjykatës. Dhe për sa kohë që 47/6 e ka të qartë faktin, si kriter ndalues, që mos të ketë qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit, unë mendoj që kjo kandidaturë nuk plotëson kriteret ligjore.

(Anëtarët kërkojnë kur është larguar zoti Saliko si inspektor nga Inspektorati.)

Pjerin Prendi: Ta marrë dy sekonda nga burimet njerëzore.

Gerd Hoxha: Më fal. Atje ligji thotë 'Këshilli i Lartë Gjyqësor', zoti President. Kthehemi përsëri tek diskutimi që bëri edhe Bruna. Ne kur duhet, na intereson, e lexojmë ligjin, themi: -KLD-ja ka vijimësi, është KLGJ. Kur nuk na intereson, themi: -Jo, kjo KLD nuk i ka kompetencat që ka KLGJ-ja. Është ai vendimi i famshëm i Gjykatës Kushtetuese, po e përdorim jo korrekt. Nëse i rrimë strikt ligjit, ai ligj flet për KLGJ-në. KLGJ-ja nuk është krijuar ende. KLD-ja ka patur tjetër problematikë, sesa të ishte pengesa për t'u zgjedhur. Në qoftë se flasim, ishte 1 vit. Faleminderit!

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Edhe unë bashkohem me Gerdin për një arsye shumë të thjeshtë. Në rast se ne do shtrimë kompetencat e KLD-së tek KLGJ-ja, i bie që kjo KLD të bëjë emërime, jo komandime më, në rast se ne do marrim termat juridik që përdoren sipas dispozitës për të cilën flitet. Po t'i referohesh edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i bie që kjo KLD të ushtrojë të gjitha funksionet e KLGJ-së. Për sa kohë që ne si KLD e kemi kufizuar veprimtarinë tonë vetëm në ato dispozita tranzitore, unë mendoj që çështja është e zgjidhur. Në rastin konkret, nuk ka nevojë për diskutime të mëtejshme. Në rast se ne do marrim tagrat e KLGJ-së, hajde i emërojmë edhe anëtarët e Gjykatës së Lartë, mos ta lejmë Gjykatën e Lartë që të jetë me vende vakante derisa të bëhet vetingu. Pastaj, kur të bëhet vetingu, le t'i heqë të gjithë. Kështu i bie.

Gerd Hoxha: Më fal, ka edhe diçka. Në rast se do zbatojmë KLGJ-në, i bie që ministrja mos të jetë në këtë tavolinë sepse nuk është anëtare. Kështu që, nuk i takon që të diskutojë fare. Kështu që, të jemi korrekt kur flasim.

Pjerin Prendi: Ka ikur në mars të vitit 2016.

Ilir Meta: Në mars... domethënë e kap 3 vjetshin.

Ka mundësi të mendoni kandidatë të tjerë? Mos t'i hyjmë këtij debati.

[shqiptaria.com]

Neritan Cena: Propozoj unë Iliba Bezatin. Ka që në 2003-shin gjyqtare.

Ilir Meta: Dakord! Kakandidaturë tjetër?

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Brunilda Kadi: Mirë atëherë, në qoftë se do ecim me dy kandidatura... e para, në qoftë se do ta përjashtojmë zotin Saliko, ta votojmë e para, e dyta pastaj, duhet të propozojmë edhe një kandidaturë tjetër që të jetë sa më... ose të futen në garë të gjithë gjyqtarët që kanë mbi katër vjet, që plotësojnë ato kriteret që citoi ministrja.

Ilir Meta: Nuk na pengon njeri të fusim të gjithë ata që plotësojnë kriteret.

Brunilda Kadi: Sepse ka edhe gjyqtare të tjera aty, për shembull Margarita Buhali. Edhe ajo ka... Sa vite ka? Pesë ka në atë gjykatë? Është magjistrate, femër. I plotëson kushtet.

Ilir Meta: Si mendoni të procedojmë?

Gjin Gjoni: Fillimisht, unë them, zoti President, të zgjidhet problemi do futet zoti Saliko, s'do futet zoti Saliko. Në rast se nuk do futet dhe të gjithë biem në një qëndrim që nuk do futet, atëherë të kalojmë tek kandidaturat e tjera.

Ilir Meta: Po mendoja që të mos i hyjmë kësaj... Meqenëse kemi një kontestim, pavarësisht nga çështja e interpretimit.

Gjin Gjoni: Dakord pra! Të bihet në heshtje që nuk do futet.

Atëherë, u dhanë dy propozimet. Të kalojmë me propozimin e parë me Iliba Bezati. Kush është dakord. Pastaj me propozimin e dytë për Margarita Buhali dhe mbyllet.

(Zoti Haxhialushi flet pa ndezur mikrofonin, duke u shprehur që të bëhet me fletë votimi.)

Komandim është. Nuk është emërim, o ti zotëri.

Ilir Meta: Po deshët me fletë votimi, me fletë votimi... Si e mendoni?

Gjin Gjoni: Me votim të hapur, zoti President, se komandim është.

Ilir Meta: Atëherë, me votim të hapur.

Kush është dakord për Iliba Bezatin?

Po! Kush është kundër?

Miratohet!

[shqiptaria.com]

Njoftojeni, se mos nuk e pranon. Ta njoftojë dikush!

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

[shqiptarja.com]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I DREJTESISË

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbledhje e Jashtëzakonshme)

(Mbajtur, më 19.11.2018)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Delegimet.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:30 dhe mbaroi në orën 19:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** ***(kryetar)***
2. ***Xhezair Zaganjori*** ***(anëtar)***
3. ***Gjin Gjoni*** ***(anëtar)***
4. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
5. ***Eneida Civici*** ***(anëtare)***
6. ***Petrit Çomo*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Astrit Haxhialushi*** ***(anëtar)***
9. ***Gerd Hoxha*** ***(anëtar)***
10. ***Neritan Cena*** ***(anëtar)***

[shqiptarja.com]

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ***z. Vangjel Kosta.***

Shënim 2: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018 bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka vendosur për subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht anëtar i KLD-sw z. Artan Broci, shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit. Deri në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimit ky gjyqtar, pezullohet nga ushtrimi i detyrës, parashikuar kjo specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.

4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.

5. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.

RENDI I DITËS:

2. Delegimet.

Ilir Meta: Atëherë, për delegimet Marsida. Për delegimet, Gerdi me Neritanin.

(Zonja ministre largohet nga salla e mbledhjes.)

Marsida Xhaferllari: Janë tre çështje paraprake tek delegimet.

1) Është një kërkesë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që tërhiqet nga kryetari i gjykatës sepse thotë që e ka bërë gabim dhe rrjedhimisht sugjerohet që të vendoset përjashtimi i kësaj kërkese nga skema e delegimit.

[shqiptaria.com]

2) Çështja e dytë lidhet me një kërkesë të gjyqtarit Gentian Marku me anë të së cilës kërkon revokimin e vendimit të KLD-së për delegimin e tij për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Si shkak për revokimin e këtij vendimi ai paraqet ngarkesën e lartë sasiore që ka në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Lidhur me këtë çështje konstatohet që shkaku i paraqitur prej tij nuk është i parashikuar nga ligji për t'u përjashtuar nga një çështje konkrete.

3) Së treti, është një kërkesë e gjyqtares Yrfete Shkreli e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet e cila ka kërkuar, për shkaqe shëndetësore të saj dhe të vajzës së mitur që ka, të përjashtohet nga procesi i delegimeve. Ka sjellë disa dokumente që tregojnë që ka probleme në shtyllën kurrizore. Nga ana e mjekut specialist është rekomanduar evitimi i udhëtimeve të gjata dhe qëndrimi ulur. Tregon edhe arsye familjare të bashkëshortit, që për arsye pune nuk ndodhet në Shqipëri, që e bën të vështirë përkujdesjen për vajzën e mitur që ka probleme shëndetësore. Në lidhje me këtë kërkesë, neni 4, pika 4 e vendimit nr. 319/2013 të KLD-së "Për delegimet", parashikon se, me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, KLD-ja vendos përjashtimin e këtij gjyqtari deri në 6 muaj nga lista e gjyqtarëve qe delegohen. Kështu që në vlerësimin tuaj nëse mendoni që ky është shkak për ta përjashtuar këtë gjyqtare për 6 muaj nga procesi i delegimeve.

4) Dhe çështja e fundit ka të bëjë me një kërkesë nga kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila kërkon që në një çështje penale specifike të delegohet gjyqtari Aurel Arapi. Bëhet fjalë për një procedim penal që ka filluar për dy të pandehur në fazën e hetimit paraprak. Në gjyq është vendosur dërgimi vetëm i një gjyqtari... për vetëm një të pandehur dhe për këtë të pandehur KLD-ja ka deleguar gjyqtarin Aurel Arapi. Ndërkohë, vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur që në fakt duhet të jenë të dy të pandehurit në gjykim. Dhe për këtë arsye, kryetarja e gjykatës kërkon gjyqtarin Aurel Arapi që ka këtë çështje në dorë.

Këto janë kërkesat paraprake. Faleminderit!

Neritan Cena: Për sa i përket zotit Marku, Gentian Marku, e vërtetë sepse mos të harrojmë që Gjykata Administrative e Shkodrës e Shkallës së Parë ka mbetur me dy

[shqiptaria.com]

gjyqtarë, plus kryetarja e gjykatës e ka me 50%. Po është për një çështje dakord. Të vazhdojë gjykimin e çështjes. Po të ishte për shumë... po të kemi në vijimësi, mos.. ta përjashtojmë nga komandimet, meqenëse ka një ngarkesë të jashtëzakonshme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke parë edhe pjesën e ngarkesës së kryetares. Në vijimësi, propozoj ta kemi parasysh që ta përjashtojmë për shkak të rrethanave specifike. Por meqenëse bëhet fjalë për një çështje, ta vazhdojë atë çështje.

Marsida Xhaferllari: Jua thashë unë juve.

Për çështjen e parë sugjerohet të vendoset përjashtimi i kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës nga delegimet për shkak të tërheqjes së kësaj kërkese nga kryetari.

Ilir Meta: Po! Vazhdojmë!

Marsida Xhaferllari: Çështja e dytë është çështja e Gentian Markut, për të cilën u propozua rrëzimi, se është kërkesë e pabazuar në ligj dhe bëhet fjalë për një kërkesë.

Ilir Meta: Po!

Marsida Xhaferllari: Për të tretën bëhet fjalë për gjyqtaren Yrfet Shkreli, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet që kërkon përjashtimin nga delegimet për 6 muaj për shkak të arsyeve shëndetësore që ka vetë dhe të fëmijës së mitur. Sugjerojmë pranimin e kësaj kërkese.

Ilir Meta: Dakord!

(Anëtarët janë dakord.)

Marsida Xhaferllari: Çështja e fundit është ajo që ka paraqitur kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për delegimin e gjyqtarit Aurel Arapi në çështjen penale.

Ilir Meta: Mendimi juaj për këtë gjë?

Marsida Xhaferllari: Të pranohet kërkesa.

Ilir Meta: Jeni dakord?

(Anëtarët janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me delegimet.

Brunilda Kadi: Nga disa gjyqtarë të apelit të Vlorës është ngritur shqetësimi që ata komandohen dhe shkojnë në Gjykatën e Apelit Korçë, ku kjo gjykatë gjykon çështje

[shqiptaria.com]

të 2018-ës, ndërkohë që ata në gjykatën e tyre kanë çështje të 2015-ës dhe sipas tyre nuk është normale që ata të shkojnë nga Vlora në Korçë, të gjykojnë çështje ndërkohë që tek gjykata e tyre janë shumë mbrapa. Ndoshta ka vend të diskutohet që kjo gjykatë, gjyqtarët e apelit të Vlorës të përjashtohen nga delegimi për të paktën për Gjykatën e Apelit Korçë që është shumë më përpara në gjykime. Thjesht nga biseda me disa prej tyre, e mora përsipër që ta ngre si çështje në mbledhje.

(Zoti President flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Meta: Të verifikohet si shqetësim.

Neritan dhe Gerdi.

Marsida Xhaferllari: Atëherë, për çështjen nr. 1 bëhet shorti mes gjykatave: apel Shkodër, apel Tiranë, apeli për krimet e rënda, për të shkuar në apel Durrës.

Neritan Cena: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: Apeli i Krimeve të Rënda. 3 gjyqtarë.

Neritan Cena: Sokol Binaj, Saida Dollani, Dhimitër Lara.

Marsida Xhaferllari: Sokol Binaj, Saida Dollani, Dhimitër Lara.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar. Për çështjen nr. 2.

Neritan Cena: Saida Dollani.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani.

Vijojmë po aty, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Idriz Mulkurti, Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti, Nure Dreni.

Tek çështja nr. 4, nga apeli Vlorë në Korçë, 2 gjyqtarë. Por jo Sokol Ngresi se ka pengesë.

Neritan Cena: Petrit Aliaj.

Marsida Xhaferllari: Petrit Aliaj. Edhe një tjetër.

Neritan Cena: Margarita Buhali.

Marsida Xhaferllari: Margarita Buhali.

Për të shkuar në Gjykatën e Apelit Korçë, shorti mes gjykatave: apeli Durrës, apeli Vlorë, apeli Gjirokastër, apeli i krimeve të rënda. (çështja nr. 5)

Neritan Cena: Apeli Gjirokastër.

[shqiptaria.com]

Marsida Xhaferllari: Apeli Gjirokastër, 3 gjyqtarë.

Neritan Cena: Enton Dhimitri, Irena Brahimi, Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri, Irena Brahimi, Miranda Andoni.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar për çështjen nr. 6.

Neritan Cena: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

Vijojmë po aty për çështjen nr. 8, 1 gjyqtar

Neritan Cena: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Tek çështja nr. 9, vijojmë po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Tek çështja nr. 10, po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar. Për çështjen 11.

Neritan Cena: Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

Për çështjen 12, po aty 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

Për 13-ën, po aty, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Irena Brahimi, Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi, Miranda Andoni.

Për 14-ën, po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

[shqiptarja.com]

Vijojmë po aty, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Enton Dhimitri, Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri, Izet Salaj.

Për 16-ën, po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Për 17-ën, po aty, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Miranda Andoni, Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni, Irena Brahimi.

Për 18-ën, nga Vlora në Korçë, por jo Sokol Ngresi.

Neritan Cena: Skënder Damini.

Marsida Xhaferllari: Skënder Damini.

Nga apeli i krimeve të rënda në Korçë. 1 gjyqtar, por jo Idriz Mulkurti. Për 19-ën.

Neritan Cena: Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Nure Dreni.

Kalo prapë te Gjirokastra që i ra shorti për të shkuar në Korçë. 1 gjyqtar për 20-ën.

Neritan Cena: Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

Po aty për 21-shin, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

22-shi, 1 gjyqtar, po aty.

Neritan Cena: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

23-shi, nga apeli Durrës në Korçë, 1 gjyqtar. Jo Anita Mici, jo Arben Vrioni se kanë pengesë.

Neritan Cena: Valbon Çekrezi.

Marsida Xhaferllari: Valbon Çekrezi.

[shqiptarja.com]

24-a, kalojmë tek apeli Gjirokastër që i ka rënë shorti për të shkuar në apel Korçë. 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

25-a po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

26-a, 1 gjyqtar, po aty nga apeli Gjirokastër për të shkuar në apel Korçë.

Gerd Hoxha: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

Po aty, për 27-ën, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

28-a, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Nga apeli Gjirokastër në apel Korçë, tek 29-a, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

Tek 30-ta, po aty, 2 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Miranda Andoni dhe Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni dhe Irena Brahimi.

31-shi, 2 gjyqtarë, po aty.

Gerd Hoxha: Miranda Andoni dhe Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni dhe Irena Brahimi.

32-shi, po aty, 2 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Miranda, Izet.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni, Izet Salaj.

33-shi, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Enton Dhimitri.

[shqiptarja.com]

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

Nga apeli Vlorë, në Korçë. 1 gjyqtar midis Iliba Bezati, Sokol Ngresi, Nazmi Trokës.

Gerd Hoxha: Nazmi Troka.

Marsida Xhaferllari: Nazmi Troka.

Tek 35-a është hedhur shorti që i ka rënë apelit Gjirokastër. Vijo, për të shkuar në Korçë, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

Tek 36-a, po aty, 3 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Irena Brahimi, Izet Salaj, Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi, Izet Salaj, Enton Dhimitri.

37-a, po aty, 3 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Irena, Izet, Enton.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi, Izet Salaj, Enton Dhimitri.

38-a po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Irena, Miranda.

Marsida Xhaferllari: Një.

Gerd Hoxha: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Tek 39-a, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Enton Dhimitri.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri.

Po aty, 1 gjyqtar. (çështja nr. 40)

Gerd Hoxha: Miranda.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

Po aty, 1 gjyqtar. (çështja nr. 41)

Gerd Hoxha: Izet.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

Po aty, 2 gjyqtarë. (çështja nr. 42)

[shqiptarja.com]

Gerd Hoxha: Izet, Enton.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj, Enton Dhimitri.

Po aty, 3 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Miranda, Izet, Irena.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni, Izet Salaj, Irena Brahimi.

Tek 44-a, 2 gjyqtarë, po aty.

Gerd Hoxha: Miranda, Enton.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni, Enton Dhimitri.

45-a nga apeli Vlorë në apelin Korçë, 2 gjyqtarë. Por jo Skënder Damini se ka pengesë.

Gerd Hoxha: Nazmi Troka, Petrit Aliaj.

Marsida Xhaferllari: Nazmi Troka, Petrit Aliaj.

Kalo edhe një herë tek Gjirokastra për të shkuar në Korçë, 1 gjyqtar për 46-ën.

Gerd Hoxha: Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni.

47-a po aty, 2 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Enton Dhimitri, Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri, Miranda Andoni.

Po aty, 3 gjyqtarë. (çështja nr. 48)

Gerd Hoxha: Izet Salaj, Enton Dhimitri, Miranda Andoni.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj, Enton Dhimitri, Miranda Andoni.

49-a, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Irena.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

50-ta, po aty, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Irena Brahimi.

Nga apeli Durrës tek apeli i krimeve te rënda. 1 gjyqtar. Jo Valbon Çekrezi se ka pengesë. (çështja nr. 51)

Gerd Hoxha: Arian Balliu.

[shqiptarja.com]

Marsida Xhaferllari: Arian Balliu.

Nga apeli Tiranë tek apeli i krimeve të rënda. 1 gjyqtar, jo Genti Shala. (çështja nr. 52)

Gerd Hoxha: Edlira Petri.

Marsida Xhaferllari: Edlira Petri.

Hidh shortin mes gjykatave: apel Korçë, krimet e rënda, Vlorë, për të shkuar në Gjirokastër. Mos bëmë short në fillim për Gjirokastrën?

Jo!

E bëmë për Durrësin.

Gerd Hoxha: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: Krimet e rënda. Për 53-shin, 1 gjyqtar.

Gerd Hoxha: Gurali Brahimllari.

Marsida Xhaferllari: Gurali Brahimllari.

Po aty, 3 gjyqtarë. (çështja nr. 54)

Gerd Hoxha: Albana, Gjovalin, Saida.

Marsida Xhaferllari: Albana Boksi, Gjovalin Përnoca, Saida Dollani.

Po aty, 1 gjyqtar. (çështja nr. 55)

Gerd Hoxha: Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Nure Dreni.

Po aty, 1 gjyqtar për 56-ën.

Gerd Hoxha: Idriz Mulkurti.

Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti.

3 gjyqtarë, por Nure Dreni, Idriz Mulkurti kanë pengesë.

Gerd Hoxha: Dhurata Haveri, Gurali Brahimllari, Gjovalin përnoca.

Marsida Xhaferllari: Dhurata Haveri, Gurali Brahimllari, Gjovalin përnoca.

58-a, po aty, 3 gjyqtarë.

Gerd Hoxha: Saida, Albana, Dhimitër.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani, Dhimitër Lara dhe Albana Boksi.

Bëj shortin mes gjykatave për të shkuar në Shkodër. Mes apelit Durrës, apelit Vlorë, apelit Tiranë, apelit të krimeve të rënda. Katër gjykata.

[shqiptarja.com]

Neritan Cena: Apeli Vlorë.

Marsida Xhaferllari: Apeli Vlorë. 3 gjyqtarë, 59-a.

Neritan Cena: Petrit Aliaj, Brikena Lubonja, Nazmi Troka.

Marsida Xhaferllari: Petrit Aliaj, Brikena Lubonja dhe Nazmi Troka.

Tek 60-a, nga apeli Durrës në apelin Tiranë, 1 gjyqtar midis Anita Micit dhe Tritan Hamitaj, se të tjerët kanë pengesë.

Neritan Cena: Anita Mici.

Marsida Xhaferllari: Anita Mici.

Tek 61-shi, shorti mes gjykatave për të shkuar në apel Vlorë. Mes apelit Gjirokastër, apelit Vlorë, apelit Durrës, apelit të krimeve të rënda, përjashto Tiranën.

Neritan Cena: Korça.

Marsida Xhaferllari: Gjykata e Apelit Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë përjashtohet, se janë 3 gjyqtarë. Kanë ngelur 3 gjyqtarë. Kështu që kap një gjykatë tjetër.

Neritan Cena: Shkodër.

Marsida Xhaferllari: Gjykata e Apelit Shkodër. 3 gjyqtarë.

Neritan Cena: Hajrie Muçmata, Aleks Nikolli, Luan Dervishi.

Marsida Xhaferllari: Hajrie Muçmata, Aleks Nikolli, Luan Dervishi.

62-shi, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Valbona Vata.

Marsida Xhaferllari: Valbona Vata.

63-shi, nga rrethi Tiranë për të shkuar në shkallë të parë të krimeve të rënda, nga dhoma penale, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Shefkie Demiraj, Kreshnik Omari.

Marsida Xhaferllari: Shefkie Demiraj, Kreshnik Omari.

64-a, nga rrethi Mat, në rrethin Dibër, 1 gjyqtar. Mes Ali Kolecit, Murat Lleshit.

Neritan Cena: Murat Lleshi.

Marsida Xhaferllari: Murat Lleshi.

Nga rrethi Kavajë në rrethin gjyqësor Durrës, 1 gjyqtar. Mes Luan Lushës, Diamela Goxhës, Genti Dokollari. (çështja nr. 65)

[shqiptarja.com]

Neritan Cena: Genti Dokollari.

Marsida Xhaferllari: Genti Dokollari.

Nga rrethi Sarandë në rrethin gjyqësor Gjirokastër, 3 gjyqtarë.

Neritan Cena: Enkeleida Doda, Nevrie Duka, Sokol Pina.

Marsida Xhaferllari: Enkeleida Doda, Nevrie Duka, Sokol Pina.

67-a, nga Kurbini në Krujë, 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Marçela Shehu, Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu, Ded Miri.

Po aty, por Ded Miri ka pengese. Mes Marçela Shehut dhe Aurel Arapit. (çështja nr. 68)

Neritan Cena: Aurel Arapi.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Nga rrethi gjyqësor Tiranë (dhoma civile), në rrethin gjyqësor Kavajë, 1 gjyqtar. (çështja nr. 69)

Neritan Cena: Migena Laska.

Marsida Xhaferllari: Migena Laska.

Nga Kurbini në Krujë, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Marçela Shehu.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu.

Po aty 2 gjyqtarë për 71-shin.

Neritan Cena: Ded Miri, Aurel Arapi.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri, Aurel Arapi.

Po aty, 1 gjyqtar për 72-shin.

Neritan Cena: Aurel Arapi.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Pukë për të shkuar në Kukës, midis Sami Ujkashit dhe Flutura Hoxhës, 1 gjyqtar. Kjo është e anuluar. Është ajo që folëm tek kërkesat paraprake. (çështja nr. 73)

Po aty, midis Sami Ujkashit dhe Flutura Hoxhës, 1 gjyqtar për të shkuar në Kukës. (çështja nr. 74)

[shqiptarja.com]

Neritan Cena: Flutura Hoxha.

Marsida Xhaferllari: Flutura Hoxha.

Nga Lezha në Kurbin, 1 gjyqtar midis Jak Ndokës dhe Artan Hajredinaj. (çështja nr. 75)

Neritan Cena: Artan Hajredinaj.

Marsida Xhaferllari: Artan Hajredinaj.

Nga rrethi gjyqësor Shkodër në Lezhë, dhoma penale e Shkodrës. (çështja nr. 76)

Neritan Cena: Besmir Stroka.

Marsida Xhaferllari: Besmir Stroka.

Çështja 77 delegohet Aurel Arapi sipas çështjes paraprake.

Nga Kurbini në Mat, 2 gjyqtarë midis Ded Mirit, Marçela Shehut, Aurel Arapit. (çështja nr. 78)

Neritan Cena: Aurel Arapi, Marçela.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi, Marçela Shehu.

Nga Korça, dhoma penale, në Pogradec, për 79-ën.

Neritan Cena: Markelian Kuqo.

Marsida Xhaferllari: Markelian Kuqo.

Nga Shkodra, dhoma penale, në Pukë, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Luveda Dardha.

Marsida Xhaferllari: Luveda Dardha.

Po aty, 1 gjyqtar për 81-shin.

Neritan Cena: Sokol Shehu.

Marsida Xhaferllari: Sokol Shehu.

Për 82-shin, po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Arbër Çela.

Marsida Xhaferllari: Arbër Çela.

83-shi, 1 gjyqtar nga rrethi gjyqësor Gjirokastër.

Neritan Cena: Pëllumb Vehbi.

Marsida Xhaferllari: Pëllumb Vehbi.

Po aty, 2 gjyqtarë por jo Blerta Çibuku, se ka pengesë. (çështja nr. 84)

[shqiptarja.com]

Neritan Cena: Mirela Iliopulli dhe Pëllumb Vehbi.

Marsida Xhaferllari: Mirela Iliopulli dhe Pëllumb Vehbi.

Për 85-ën, 1 gjyqtar po aty.

Neritan Cena: Mirela Iliopulli.

Marsida Xhaferllari: Mirela Iliopulli.

86-a, nga rrethi gjyqësor Vlorë, në rrethin gjyqësor Sarandë. 1 gjyqtar. Arqile Basho, Herila Çela, Ervin Trashi, kanë pengesë. Mes Elona Mihalit, Hektor Sinanit, Esmeralda Habili, Mirela Mishgjoni. 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Esmeralda Habili.

Marsida Xhaferllari: Esmeralda Habili.

Nga rrethi gjyqësor Korçë, me gjyqtarët mbi 5 vjet, në administrative të shkallës së parë Korçë. 1 gjyqtar. (çështja nr. 87)

Neritan Cena: Markelian Kuqo.

Marsida Xhaferllari: Markelian Kuqo.

Po aty, 1 gjyqtar tjetër për 88-ën.

Neritan Cena: Arben Lera.

Marsida Xhaferllari: Arben Lera.

89-a, nga rrethi gjyqësor Gjirokastër në administrative të shkallës së parë Gjirokastër, me gjyqtarët mbi 5 vjet.

Neritan Cena: Pëllumb Vehbiu.

Marsida Xhaferllari: Pëllumb Vehbiu.

90-a, janë bashkuar Gjirokastër dhe Sarandë. Midis Mirela Iliopullit, Nevrie Dukës dhe Enkeleda Dodës, 2 gjytarë.

Neritan Cena: Nevrie Duka dhe Enkeleida Doda.

Marsida Xhaferllari: Nevrie Duka dhe Enkeleida Doda.

Nga rrethi gjyqësor Gjirokastër, në administrative Gjirokastër, mbi 5 vjet. 2 gjyqtarë.

Neritan Cena: Mirela Iliopulli, Pëllumb Vehbiu.

Marsida Xhaferllari: Mirela Iliopulli, Pëllumb Vehbi.

92-shi, po aty, 2 gjyqtarë.

[shqiptarja.com]

Neritan Cena: Pëllumb Vehbiu, Mirela Iliopulli.

Marsida Xhaferllari: Pëllumb Vehbiu, Mirela Iliopulli.

Kalojmë tek relacioni shtesë.

Për në apelin Durrës, kë caktuam ne nga gjykatat e apelit?

Krimet e rënda. Përveç Saida Dollanit (gjyqtares i ka rënë shorti në relacionin/tabelën e parë), do edhe dy të tjerë. (çështja nr. 1)

Neritan Cena: Saida Dollani, Dhimitër Lara, Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani, Dhimitër Lara, Albana Boksi.

Në Korçë, kush thamë që shkonte në Korçë?

Gjirokastrës i ka rënë. 2 gjyqtarë. (çështja nr. 2)

Neritan Cena: Miranda Andoni, Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Miranda Andoni, Irena Brahimi.

Po aty, 1 gjyqtar. (çështja nr. 3)

Neritan Cena: Izet Salaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Salaj.

Po aty, 2 gjyqtarë. (çështja nr. 4)

Neritan Cena: Enton Dhimitri, Irena Brahimi.

Marsida Xhaferllari: Enton Dhimitri, Irena Brahimi.

Për çështjen 5, nga Kukësi në Tropojë.

Neritan Cena: Erion Çela.

Marsida Xhaferllari: Erion Çela.

1 gjyqtar, po aty. (çështja nr. 6)

Neritan Cena: Alma Zhupa.

Marsida Xhaferllari: Alma Ahmeti.

7-a, po aty, 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Rexhep Karaj.

Marsida Xhaferllari: Rexhep Karaj.

Po aty, 1 gjyqtar për 8-ën.

Neritan Cena: Alma.

Marsida Xhaferllari: Alma Ahmeti.

[shqiptarja.com]

Po aty, 1 gjyqtar. (çështja nr. 9)

Neritan Cena: Erion Çela.

Marsida Xhaferllari: Erion Çela.

Nga rrethi gjyqësor Shkodër, dhoma penale, 3 gjyqtarë për të shkuar në Tropojë.

Neritan Cena: Luveda Dardha, Besmir Stroka, Tonin Stërkaj.

Marsida Xhaferllari: Luveda Dardha, Besmir Stroka, Tonin Stërkaj.

Nga rrethi Shkodër, gjyqtarët mbi 5 vjet. 1 gjyqtar.

Neritan Cena: Izabela Radovani.

Marsida Xhaferllari: Izabela Radovani.

Mbaruam.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

[shqiptarja.com]